



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:194901

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05707200

A.nr.2006/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni dhe me bashkëpunëtoren profesionale Donjeta Nikolla, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses, B.B. nga ... me adresë në rrugën ..., të cilën e përfaqëson ... kundër të paditurve, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK) me seli në Prishtinë, dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës me seli në Prishtinë, me bazë juridike: anulim vendimi, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit të paditëses e në mungesë të të paditurave, me datë 18.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses, ... nga ... me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e saj dhe të anulohet si i kundërligjshëm vendimi me numër KA.nr.09/2020 i datës 26.02.2020 i protokolluar me datën 02.03.2020 me numër 01/252, i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe po ashtu Njoftimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës Për Shërbimin Civil të Kosovës i datës 08.06.2021, me numër Reference A.nr.519/2021, ashtu që paditëses ti njihet e drejta në punë me orar të shkurtuar prej 4 (katër) orëve, si dhe ndërrimin e vendit të punës sipas rekomandimeve të ekspertëve mjekësorë, si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (më tutje LKA-së), në prani të përfaqësuesit të paditëses, e në mungesë të të paditurave KGJK dhe KPMSHCK të ftuara në mënyrë të rregullt (provë: fletëkthesat e datës 19.03.2024).

Paditësja me padinë e datës 01.09.2021 dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, përmes përfaqësuesit të saj, ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadija e saj dhe të anulohet si i kundërligjshëm vendimi me numër 01/252 i datës 02.03.2020 i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe po ashtu Njoftimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës Për Shërbimin Civil të Kosovës i datës 08.06.2021, me numër Reference A.nr.519/2021, ashtu që paditëses ti njihet e drejta në punë me orar të shkurtuar prej 4 (katër) orëve, si dhe ndërrimin e vendit të punës sipas rekomandimeve të ekspertëve mjekësorë. I njëjti e ka njoftuar gjykatën se paditësja i ka shterrur të gjitha mjetet juridike në këtë procedurë ku edhe gjykata me datë 01.06.2021 ka marrë aktgjykim me të cilin ka aporvuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ka anuluar aktin administrativ të datës 21.01.2019 dhe njëherit ka detyruar të paditurën të vendosë për ankesën. Më tutje ka theksuar se e paditura e ka pasur të pamundur të vendosë për çështjen, mirëpo e njëjta përsëri ka nxjerr aktin administrativ-njoftimin e datës 08.06.2021 me numër 519-2021 me të cilin e ka njoftuar paditësen se nuk mund të vendosë, për arsye të mos kuorumit të bordit të Këshillit. Ai thekson se paditësja i ka shterrur të gjitha mjetet juridike, para se të paraqiste padi në gjykatë. Shton se, punëdhënësi ka konstatuar në mënyrë të gabuar, kur ka refuzuar kërkesën e paditëses lidhur me shkurtimin e orarit të punës, që e përcakton Rregullorja numër 31/2012, me arsyetimin se Komisioni nuk ka specifikuar dëmin e shkaktuar nga ushtrimi i punës. Më tutje ka kërkuar nga gjykata që ti njihet e drejta për rimbursimin e pagave.

I padituri KPMSHCK në përgjigjen – njoftimin e datës 19.01.2024, ka theksuar se, Këshilli për arsye se nuk ka pasur anëtar nuk ka mundur ta shqyrtojë ankesën e ankueses ..., ku përmes shkresës së datës 08.06.2020 me numër protokolli 1072/2020, e ka njoftuar ankuesen, këtu paditësen, se nuk mund të vendosë lidhur me ankesën e saj dhe e ka udhëzuar që të paraqesë konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative.

I padituri KGJK, në përgjigjen në padi të datës 26.02.2024 ka theksuar se, e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, duke i propozuar gjykatës që të refuzojë kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar, për arsye se në rastin konkret është aprovuar kërkesa e paditëses për pensionim të parakohshëm, çka nënkupton se kërkesa e saj për lejimin e punës për 4 orë në ditë, tani më nuk ka kurrfarë efekti.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 18.04.2024, ka administruar provat relevante dhe atë:

Vendimi i datës 26.02.2020 me numër reference 09/2020; Lexohet vendimi i datës 01.10.2018; formulari për shqyrtimin e ankesave–divizionit mjekësorë i datës 21.03.2019; Raporti Mjekësor i datës 18.02.2020; raporti i datës 12.02.2020 me numër 184/20; E-mail i datës 29.04.2020; Njoftimi i datës 08.06.2021; Ankesa e datës

10.04.2020; Shkresa e datës 14.08.2014; Kërkesa e datës 14.03.2019 me numër 01; Kërkesa e datës 15.09.2018; E-mail i datës 05.06.2018 dhe 13.06.2018, E-mail i datës 01.09.2018, 15.09.2018; 03.09.2019; 20.09.2020; 10.09.2020; 18.04.2019; Shkresa e datës 03.03.2020; E-mail i datës 06.06.2020; 17.01.2020; 14.01.2020; 08.01.2020; Ankesa e dt.01.08.2020; E-mail i datës 31.03.2020; Formulari për regjistrimin e ankesave 10014/2020; E-mail i datës 27.04.2020; 08.04.2020; Vendimi i .datës 26.02.2020; Procesverbali i takimit te Komisionit te KGJK di datës 26.02.2020; Akt emërimi i datës 27.12.2012; Njoftimi i datës 20.10.2020; Njoftimi i datës 08.06.2020; Aktgjykimi i datës 01.06.2021 me numër A.nr.814/20; Vendimi i datës 22.02.2024 me numër 125/2024 me numër protokollit 243.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e akteve administrative të goditura me padi në përputhje me nenin 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, thënieve në padi dhe përgjigjeve në padi të të paditurave dhe deklarimin në seancën e shqyrtimit kryesor dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës së kësaj çështje administrative, konstatoi se padia është e pabazuar.

Me vendimin e datës 26.02.2020 të protokolluar me datën 02.03.2020 të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës – Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave është refuzuar si e pa bazuar ankesa e datës 21.02.2020 e parashtuar nga ..., ndaj Njoftimit të datës 07.02.2020, me arsyetimin se, Komisioni nuk ka vendosur se problemet shëndetësore ndaj ankueses, këtu paditëses, janë shkaktuar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, ashtu që Komisioni konsideron se realizimi i një të drejte të tillë është në kundërshtim me Rregulloren numër 31/2012 Për Procedurat e Përkujdesjes për Nëpunësit Civil.

E pakënaqur me këtë vendim, paditësja ka parashtuar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku i njëjti me Njoftimin e datës 08.07.2021, e ka njoftuar paditësen se e ka të pamundur që të vendosë për ankesën e saj për arsye se Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën plenare të mbajtur me datë 30.06.2021 ka shkarkuar pesë (5) anëtarët e Këshillit, ku në këtë rast Këshilli ka mbetur pa anëtarë, duke e udhëzuar kështu të njëjtën që të

fillojë procedurat gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Paditësja e pakënaqur me këtë akt administrativ ka parashtruar padi në këtë gjykatë, duke kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Në bazë të nenit 16 paragrafi 3 i Ligjit Nr.006/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përcaktohet se:” Në emër të Këshillit, ankesat i shqyrton dhe i vendos Kolegji i përbërë nga tre (3) anëtarë, i cili përcaktohet me vendim të Këshillit”. Kështu që kjo e ka bërë të pamundur që Këshilli të vendosë për ankesën e paditëses, për shkak se Këshilli nuk ka pasur anëtarë, sepse Kuvendi i Republikës së Kosovës me datën 30.06.2021 i kishte shkarkuar pesë (5) anëtarët e Këshillit.

Në bazë të nenit 21 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendimi i Këshillit paraqet vendim administrativ të formës së prerë dhe i njëjti është i ekzekutueshëm.

Gjykata duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi i’u referua dispozitave ligjore të Rregullores numër 31/2012 Për Procedurat e Përkujdesjes për Nëpunësit Civil, ku në nenin 1 të saj theksohet se:” Kjo Rregullore përcakton rregullat dhe procedurën për përkujdesjen ndaj nëpunësve civil të cilëve u ndërpritet marrëdhënia e punës apo transferohen/ricaktohen në vend tjetër të punës, për shkak të paaftësisë fizike ose problemeve shëndetësore të shkaktuara gjatë kryerjes së detyrës zyrtare”. Në këtë rast paditëses nuk i është vërtetuar se këto paaftësi ju kanë shkaktuar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare.

Gjykata në shkresat e lëndës gjeti se, me vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KGJK-së me Referencë DS-105/2024 të datës 21.02.2024. është aprovuar kërkesa e paditëses për pensionim të parakohshëm me 70% të pagës bazë, të periudhës së mbetur deri në moshën e pensionimit të vjetërsisë, e cila pagë nuk përfshin shtesat dhe kompensimet tjera në total prej 331.10 Euro bruto, i cili vendim fillon të zbatohet nga data 16 Mars 2024.

Andaj, duke marrë parasysh që në rastin konkret është aprovuar kërkesa e paditëses për pensionim të parakohshëm, sipas vullnetit të saj, ngase janë përmbushur kushtet ligjore, ashtu

që në rastin konkret është krijuar një rrethane e re, ku paditëses nga data 16 Mars 2024, i përfundon marrëdhënia e punës , çka nënkupton se kërkesa e saj për lejimin e punës për 4 (katër) orë në ditë tani nuk ka kurrfarë efekti.

Mbi këtë gjendje të fakteve, kjo gjykatë konstaton se në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditëses, andaj gjykata nuk i aprovoi pretendimet e paditëses, sepse i vlerësoi si pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga ana e organeve administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr. 2006/2021 data 18.04.2024

Bashkëpunëtore Profesionale
Donjeta Nikolla

G j y q t a r e
Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.